

K.U.D 37: 329.73 (496.51) (091)

Prof. dr. Sulltane KOJQINI-UKAJ

KONTRIBUTI I KOMITETIT MBROJTJA KOMBËTARE E KOSOVËS NË ARSIMIMIN E KOSOVARËVE

Përpjekjet e patriotëve kosovar për arsimimin e shqiptarëve nga Kosova në shkollat e shtetit shqiptar kanë qenë të hershme. Në këtë drejtim duhet veçuar kontributin e pazëvendësueshëm të Hasan Prishtinës e të Bajram Currit.

Në kohën e vllugut të madh të propagandës se huaj kundër alfabetit dhe shkollës shqipe Hasan Prishtina u angazhua që në Normalen e Elbasanit të përfshihen edhe të rinjtë nga Kosova. Këto përpjekje u kurorëzuan me përfshirjen e nxënësve nga Vushtrria dhe Gjilani ndërsa një vit më vonë 1910 me ndihmën e pakursyer të Bajram Currit e të Bedri Pejani në Normalen e Elbasanit nga Kosova u dërguan edhe 19 shkollat të tjerë.¹

Nxënësit ishin kryesisht nga Gjakova, Prishtina, Vushtrria, Mitrovica, Peja e Struga.² Normalja e Elbasanit ishte fidanishtja e parë e kuadrit arsimor në Shqipëri dhe Kosovë.

Duke e ndier nevojën e madhe të kuadrit arsimor për shkollat në Kosovë, Hasan Prishtina me 24 janar të vitit 1910 me anë të gazetës Sabah të Stambollit kërkonte 10 mësues për mësonjëtorët shqipe në Kosovë³ duke u shprehur se këta mësues do ti mbante me mjetet e veta. Ai për hapjen e shkollave shqipe, u zotua se do të japë 5% nga të ardhurat që ka në vit dhe kërkoi që shembullin i tij ta ndiqnin edhe atdhetarë tjerë shqiptarë që kishin mundësi materiale.

1 Tahir Abdyl, *Hasan Prishtina në Lëvizjen Kombëtare e Demokratike Shqiptare 1908-1933*, Prishtinë 2003, f.75; Hakif Bajrami, *Bedri Pejani një jetë e një vdekje për Shqipëri etnike 1885-1946*, Prishtinë 1994, f. 8.

2 Nimon Ferizi, *Familja Curri*, Shtypshkronja "Albania" Konstancë, 1935, f. 11.

3 Po aty, f. 75.

Ishte koha kur kishin filluar të formoheshin klubet shqiptare brenda dhe jashtë tokave shqiptare. Me shkollën shqipe në vilajetin e Kosovës kryesisht u mor Klubi Shqiptar i Shkupit. Ky klub ishte formuar në vitin 1908 me kërkesën e Hasan Prishtinës. Bajram Currit, Nexhip Dragës e Bedri Pejani të gjithë anëtar dhe përkrahës të devotshëm të Komitetit Mbrojtja Kombëtare e Kosovës (KMKK).

Me përpjekjet e Hasan Prishtinës e Bajram Currit u hapën shkolla shqipe edhe në Kosovë si: në Vushtrri, Gjilan, Gjakovë etj. Këto zhvillime i pasqyron edhe gazeta Dielli e Bostonit më 26 nëntor 1909. Ja se çka shkruan kjo gazetë “ ...lëvizja kombëtare ka nisë m’u ngjallë shumë në Kosovë...ndër këto ditë , me të përpjekurat e Hasan Beut, deputetit Prishtinës, u hap një mësonjëtoje tjetër afër Vuçitërnës... priten për së shpejti qi Hasan Beu të çelin edhe një mësonjëtoje tjetër (shqipe) brenda në Vuçitërnë ku ka shpin’e vet. Prej këtij atdhetari të nderëm priten shumë punë të dobishme për kombin....”⁴

Këtë rrugë të Hasan Prishtinës, Bajram Currit dhe shumë të tjerëve do ta ndjek me ngulm edhe më të madh Komiteti Mbrojtja Kombëtare e Kosovës dhe kryetari Hoxhë Kadriu.

Pas LPB-e (1918) Kosova u riokupua nga forca të mëdha serbe. Beogradi mori masa të rrepta kundër shqiptarëve të Kosovës pikërisht sa i përket ngritjes së vetëdijes kombëtare dhe përpjekjes së arsimimit në gjuhën shqipe. Shkollat shqipe që vepruan gjatë Austro-Hungarisë u mbyllën ose u shndërruan në shkolla serbe. Libri shqip ishte i ndaluar. Këtë e vërteton raporti i aktivistit të Partisë Radikale Punisha Raçiq, më 17 maj 1921, në të cilin theksonte se “shqiptarët janë të pashkolluar dhe analfabetë, ata nuk kanë mundësi që në rrugë legale të mbrohen nga veprimet e paligjshme dhe padrejtësitë që iu bëjnë organet e pandërgjegjshme shtetërore....”⁵ Komiteti i Kosovës përpiquej që t’i informonte fuqitë e huaja më hollësisht mbi gjendjen tragjike në Kosovë.

Nga një letër e 20 gushtit 1919 mësohet se qëllimi i qeverisë jugosllave ishte që të internohen dhe të burgosen kryesisht ata që dinin shkrim-lexim.⁶

4 *Mendimi politik e shoqëror i Rilindjes Kombëtare Shqiptare*, (Përmbledhje artikujsh nga shtypi), Vëllimi II 1908-1910, Tiranë , 1976, f. 209.

5 Bogumil Hrabak, *Jedan radikalni izveshtaj o stanju na Kosovu 1921 godine*, Vjetari IV-V, Arkivi i Kosovës, Prishtinë 1971, f. 215.

6 Lush Culaj, *Komiteti Mbrojtja Kombëtare e Kosovës 1918-1924*, Prishtinë 1997, f.

Qëllimi parësor i kësaj politike ishte që ky popull të mbetej në errësirë e padituri në mënyrë që të mos ishte i denjë të luftonte për të drejtat e veta kombëtare. Shkollimi në shkollat serbe për pushtetin konsiderohej formë e përshtatshme që në mënyrë të organizuar e institucionale të veprohej për shkombëtarizimin e shqiptarëve që kishin mbetur në përbërje të Mbretërisë jugosllave.⁷

Kjo politikë ndikoi që shumë të rinj shqiptarë nga Kosova dhe viset tjera etnike shqiptare të gjenin rrugë të mundshme shkollimi. Mundësia e vetme ishte shkollimi në Shqipëri dhe në shtetet tjera ku epej mundësia. Mbretërinë jugosllave e pengonte çdo përpjekje e shkollimit të shqiptarëve, në veçanti në shkollat brenda shtetit shqiptar. Ajo konsideronte se shkollimi i tyre paraqiste një rrezik të madh për Jugosllavinë borgjeze nga se krijonte një plejadë të inteligjencës shqiptare në Kosovë që do të dinte t'i kërkonte dhe t'i mbronte të drejtat e veta kombëtare.⁸

Jugosllavia borgjeze jo vetëm që kishte shuar dhe shuante çdo tendencë të zhvillimit kulturor -arsimor, por synonte edhe asimilimin e plotë të shqiptarëve duke pasur objekt sulmi kulturën, traditën, doket dhe zakonet e tyre.

Mësimdhënësit shqiptar që kishin punuar në vitet 1916-1918 në shkollat shqipe në Kosovë nën kërcënimin e zhdukjes fizike shpërndahen në katër anët e tokave shqiptare për ta vazhduar misionin e shenjt – edukimin e gjeneratave të reja. Me ta u larguan edhe nxënësit e tyre. Po kjo politikë ndoqi shumë atdhetar nga Kosova që u sistemuan në Shqipëri.

Situata e ndërlikuar në Kosovë, impononte themelimin e një organizate e cila në programin e saj do të zhvillonte aktivitet në shumë rrafshë. Për këtë në Shkodër me 1 maj 1918 u themelua Komiteti Mbrojtja Kombëtare e Kosovës.

Hoxha Kadriu duke qenë në krye të Komitetit “Mbrojtja Kombëtare e Kosovës”, luftoi kundër ricoptimit të Shqipërisë, për zhvleftësimin e Traktatit të Fshehtë të Londrës të prillit 1915, për sigurimin, ruajtjen, e mbrojtjen e pavarësisë e tërësisë tokësore të

125.

7 AJ. Fondi.Ministria e Arsimit, sig. 66-72-25, viti 1930.

8 AJ. Ministria e Arsimit, sig. 66-22-187, viti 1931.

Shqipërisë dhe në bazë të të drejtës së kombeve për vetëvendosje, u mundua të arrijë bashkimin e të gjithë shqiptarëve në një shtet të lirë, sovran e të pavarur.

Duke u nisur nga fakti se pa arsim kombëtar dhe kulturë kombëtare një popull nuk mund të numërohet i qytetëruar Komiteti i Kosovës, veçoi arsimin si shtyllë të rëndësishme të emancipimit kombëtar. Bartësit e këtij komiteti shpreheshin se “vetëm populli që gëzon të drejtën të arsimohet në gjuhën amtare siguron vetës kulturë dhe ardhmëri të sigurt. Kryesia e Komitetit të Kosovës kishte për parim : “Burrat e shtetit që duan të drejtojnë qeverinë , duhet të mbështetën në inteligjencën sepse ajo drejton kah të dojë vetëdijen kombëtare”.⁹ Në këtë kontekst Hoxha Kadriu, mësuesin që për kohën ishte forca intelektuale, e quante jo vetëm edukatorë, por edhe luftëtar, edukues e drejtues të ndërgjegjes kombëtare. Për këtë arsye, Komiteti aktivizoi dhe përfshiu në veprimtarin e vet shumë mësime të mësuara.

Komiteti i Kosovës udhëhoq nga intelektual e atdhetar të dëshmuar si Hoxhë Kadri Prishtina, Bedri Pejani, Hysni Curri, Qerim Begolli, Halim Gostivari etj, të ndihmuar e të përkrahur nga emra të mëdhenj të arsimit kombëtar, si; Sali Gjuka, Ahmet Gashi, Qamil Bala, Ibrahim Fehmiu, Nimon Ferizi, Ibrahim Kolqi, Ramiz Binishi, Beqir Vokshi, Ahmet Gashi, Isuf Mexhiniani nga Prishtina e shumë të tjerë. Më angazhimin dhe mbështetjen e kryetarit Hoxhë Kadriut dhe anëtarëve tjerë të Komitetit të Kosovës si: Hasan Prishtina, Bajram Curri, Bedri Pejani etj u arrit regjistrimi dhe sistemimi i shkollarëve kosovar në Shkodër, Elbasan, Krumë, Kolgecaj etj. Kruma do të bëhet qendër e kosovarëve dhe vend i pritjes së shkollarëve të rijë nga Kosova. Aty qëndruan Bajram Curri, Ibrahim Fehmiu, Nimon Ferizi, Hysni Zajmi, Hasan Prishtina etj.

Jup Binaku ndihmonte djalërinë kosovare të regjistrohesh në Gjymnazin e Shkodrës. Në Shkodër ishte edhe Fadil Hoxha dhe Hysni Zajmi.

Shteti shqiptar, për nxënësit nga Kosova caktoi një numër bursash. Në një raport të Prefekturës “Kosova”dërguar Ministrisë së Arsimit në gusht të vitit 1923, ndër të tjera thuhej: ”Kjo Prefekturë ka ngelë në një pozicion tepër të vështirë para kërkesave që janë t’u ju

⁹ Pal Doçi, *Hoxha Kadri Prishtina*, Geer 2005, f. 145.

bë prej djemve të vegjël të Kosovës, që tue lanë pllangë e shtëpi . gjithnjë po vijnë e kërkojnë me u futur në shkollat e Shqipnis ..sado që kemi marrë masa me i futë një pjesë të këtyre djemve ndër shkollat e këtij qarku, kurrresi nuk po mundemi me u bë ballë drejtimeve të pareshtura.¹⁰

Në ndihmë këtyre shkollarëve u vinin edhe bartësit e Komitetit të Kosovës si: Hoxhë Kadriu, Hasan Prishtina, Bajram Curri, Sali Mani që shtëpitë e tyre ishin kthyer në çerdhe për strehim dhe ndihmë shkollarëve nga Kosova.

Shkolla me internatin “Kosova “ në fillim në Kolgecaj e më vonë në Krumë, u bë çerdhe e arsimtarëve dhe të rinjve kosovar.¹¹

Në Krumë themelohet shoqëria Kulturo Arsimore “Shkëlzeni”. Në themelimin e kësaj shoqërie morën pjesë edhe anëtarët e KMKK si Nimon Ferizi, e Hamdi Zajmi nga Gjakova.¹²

Nën ndikimin e kësaj shoqërie dhe ndihmës së pakursyer të Avni Rrustemit në Krumë, Bicaj, e Gjakovë formohet shoqëria “Bashkimi”. Avni Rrustemi ishte nismëtar i formimit të shoqërive të tilla edhe në Kosovë.¹³ Formimi i shoqërisë “Bashkimi” ishte ngushtë i lidhur me emrat e mësimdhënësve të dalluar të kohës si: Sali Morina, drejtor i internatit “Kosova, Ibrahim Kolqit, mësues në Kolgecaj dhe Qamil Luzha mësues në Krumë. Në këtë drejtim kontribut të çmuar dhanë edhe mësuesja e parë gjakovare, Emine Sheh-Dula, Qazim Bakalli, Osman Shairi, Jusuf Dushi, Ramiz Binishi. etj.¹⁴ Që të gjithë mësuesit përqaftuan programin e Shoqërisë “Bashkimi” të Avni Rrustemit, duke iu bashkuar, kësodore, lëvizjes demokratike në Shqipëri, të cilës i printe në Malësi Bajram Curri. Pas vrasjes së Avni Rrustemit, me 24 -26 nëntor mbahet kuvendi i jashtëzakonshëm i shoqërisë “Bashkimi” dhe drejtimin e kësaj shoqërie e mori Lazar Fundo, ndërsa degët në Has dhe Lumë të kësaj shoqërie i udhëhoqi Tahir Zajmi.¹⁵

Kishte edhe të tillë që vijonin shkollat ushtarake në Itali e Austri . Bajram Curri si vizionar që ishte, pati këshilluar të rinjtë “Vatanit i duhen oficer të shkolluar dhe të guximshëm”.¹⁶

10 Masar Rizvanolli, *Kosova nr-31/32*, Prishtinë 2009, f. 32.

11 Ali Lllunji, *Beqir Kastrati legjendë e arsimit kosovar*, Prishtinë 2001, f. 84.

12 Shkelzen e Blerim Zajmi , *Familja Zajmi*, Gjakovë 2010, f. 158.

13 Sajfi Vllamas, *Ballafaqime politike ne Shqipëri*, f. 432-433.

14 Shkelzen dhe Blerim Zajmi, *Familja Zajmi* , Gjakovë 2010, f. 158.

15 Po aty, f.161.

16 Prof. dr. Sultane Kojqini-Ukaj “*Qazim Komoni komandant i ushtrisë shqiptare në*

Shqipëria pas ardhjes së Ahmet Zogut në pushtet, kishte dërguar një numër të rinjsh për studime e specializime në sfera të ndryshme të shkencës, kulturës dhe artit ushtarak në shumë universitete të Italisë dhe Austrisë. Edhe pse Shqipëria e atyre viteve kalonte përmes krizave të mëdha ekonomike dhe financiare, Zogu këmbëngulte që fondet e shkollimit të shqiptareve, jashtë vendit, të mos zvogëloheshin.¹⁷

Shteti shqiptarë duke e parë pozitën e vështirë të shqiptarëve në Kosovë veçmas sa i përket arsimit në gjuhën amtare, ndoqi një politikë konstruktive dhe bëri përpjekje për shkollimin e të rinjve nga Kosova dhe furnizimit me libra shqip. Kjo pasqyrohet edhe në një raport të Konsullit shqiptar në Shkup më 19 mars të vitit 1936. Konsulli nga Shkupi informonte ministrin e Punëve të Jashtme Dr. Fuat Asllanin „se gjatë tre vjetëve që drejtoi këtë Kryekonsullatë Mbretërore jam munduar me gjithë fuqirat e mia të tërheq interesimin e shqiptarëve të Kosovës për gjuhën shqipe me shpërndarjen e librave shqipe dhe përpjekjet e mia kanë dhënë rezultate tepër të favorshme „sidomos në dy vjetet e fundit....Librat i kemi shpërnda me anën e besnikëve dhe dashamirëve t’onë nëpër viset e ndryshme të Kosovës dhe me kënaqësi shpirtërore më të madhe „jemi t’ue konstatue se s’ka javë që të mos na drejtohen kosovarë për të na kërkuar libra shqipe, të cilat me mjetet t’ona të fshehta dhe të sigurta, jemi tue ua dorëzue kërkuesvet.

Konsulli i drejtohet MPJ për dërgimin e një numri të konsiderueshëm të librave shqip e veçmas kërkonte 5000 copë abetare për shkollat popullore shqipe.¹⁸

Në vitin 1937 nën kryesinë e ministrit të Punëve të Jashtme z. Ekrem Libohova u krijua një komision për mbrojtjen e shqiptarëve në Kosovë nga shkombëtarizimi edhe përmes shkollës. Komisioni hartoi një program pune që përfshinte disa pika. Njëra ndër kërkesat ishte: Të organizohej rinia intelektuale e Kosovës duke pasur organin e saj në tokën jugosllave në formën e një fletoreje ose reviste kulturore letrare; qeveria jugosllave duhej të tregojë më tolerante me shqiptarët dhe të drejtat e tyre për t’u arsimuar në gjuhën amtare...

mbrojtje të Kosovës dhe kufijve të saj. " Kosova " nr 34 , Prishtinë 2010, f. 4.

17 *Prirjet e qeverisë së Zogut kanë qenë drejt Pendimit*, "Bota sot", Prishtinë 1 prill 2011, f. 16-17.

18 Hasan Bello, *Mbreti Zog dhe shpërnguljet drejt Turqisë*. "Shenja " nr. 5 , Shkup, f. 66-67.

Në këtë kohë edhe Italia ndau bursa për nxënësit shqiptar. Janë me qindra studentë shqiptarë të cilët u shkolluan dhe kontribuuan për të integruar kombin shqiptar në rrjedhat e botës së civilizuar. Kjo mundësoi që të rinjtë nga Kosova të vijonin akademinë ushtarake në Itali.¹⁹ Do të përmendim Qazim Komanin, Shaban Bashën, Ibrahim Gjakovën, Hysni Rudin të cilët mbaruan akademinë ushtarake në Toronto të Italisë.²⁰ Këta oficer si shumë të tjerë në rrethana të caktuara u inkuadruan në mbrojtjen e sovranitetit tokësor të Shqipërisë etnike. Kjo ishte e arsyeshme se pse Kosovës i nevojiteshin profile të ndryshme shkollorësh, pra edhe ushtarakë të shkolluar.²¹

Komiteti që nga viti 1918 u bë zëdhënës i aspiratave të popullit shqiptar të Kosovës dhe viseve tjera etnike në ish Jugosllavi për tu bashkuar me atdheun nga i cili ishte shkëputur padrejtësisht dhe me dhunë. Sipas statusit komiteti mbante dy qendra: qendrën e brendshme në Shkodër dhe qendrën e jashtme në Gjenevë. Të dy qendrat udhëhiqeshin prej Këshillit Qendror.²²

Komitetit MKK i dhanë një shtytje të veçantë aktivistët jashtë Shqipërisë veçmas degët e shumta në Kosovë dhe Gjenevë. Në saje të përpjekjeve të pareshtura të Hoxha Kadriut, në korrik të vitit 1919 nëpërmjet qeverisë së Durrësit Komiteti KMK mundi të dërgojë si ekspertë përfaqësuesit e vet në Parisë për të parashtruar në Konferencën e Paqes pikëpamjet e Komitetit KMK dhe për të vendosur lidhje të drejtpërdrejta me delegacionet shqiptare që gjendeshin atje.²³ Dhunën dhe padrejtësitë mbi shqiptarët, jugosllavët e fshinin me censurë të ashpër dhe propagandë antishqiptare. Komiteti MKK me qendër në Shkodër ndonëse në kushte mjaft të vështira, angazhoi pjesëtarët e saj në terren të mbledhnin informata për torturat, vrasjet dhe djegiet e shtëpive të shqiptarëve, sidomos në Kosovë. Këto të dhëna dërgoheshin përmes degëve në Ligën e Popujve në Gjenevë.

Përmes degëve të organizuara në Kosovë, veçmas asaj të Gjakovës, Komiteti kishte shtrirë aktivitetin e vet edhe në Prizren, Pejë, Ferizaj, Shkup, Vushtrri e vende tjera. Me këtë rast do përmendim

19 Po aty, f. 7.

20 Prof. dr. Sulltane Kojqini-Ukaj, punim i cituar, f. 8.

21 Po aty, f. 24-26.

22 Pal Doçi, *Hoxha Kadri Prishtina*, Geer, 2005, f. 23.

23 Po-aty.

aktivitetin e mësuesit Murat Muhaxhiri, nga Gjakova. Ai ishte ngarkuar nga Komiteti me një detyrë mjaft delikate dhe të rrezikshme të punonte si përkthyes i nënprefektit dhe i komandantit të garnizonit serb në Gjakovë dhe të gjitha shkresat sekrete ia dërgonte Kryesisë së KMK në Shkodër.²⁴

Se sa aktiv dhe të besueshëm ishin mësuesit në Komitetin e Kosovës flet edhe fakti se Hoxha Kadriu mësuesve nuk iu besonte vetëm detyra politike por edhe ushtarake. Ai porosite Komitetin në Bunjaj, Po të zëni Qafën e Morinës ,vendosni atje postën kufitare me një nga mësuesit si komandant.²⁵

Bartësit e ideve dhe të synimeve të Komitetit të Kosovës që vepronin në qendra të ndryshme të Kosovës u përpoqën t'i sendërtojnë idetë dhe programin në forma të ndryshme. Me angazhimin e aktivistëve të degës në Gjakovë si: Qazim Bakalli, Beqir Vokshi, Niman Ferizi, shumë të rinj kaluan kufirin për të vazhduar mësimet në qendrat e ndryshme të arsimit në Shqipëri, etj.²⁶

Niman Ferizi anëtarë i devotshëm i Komitetit u angazhua në hapjen e shkollave shqipe në Gjakovë, Bunjaj, Bicaj, Kalimash, Krumë, Kolgecaj etj. Në kuadër të shumë përpjekjeve të Komitetit u bënë edhe shumë memorandume e peticione të dërguara Lidhjes së Kombeve në Gjenevë për mbrojtjen e të drejtave të shqiptarëve në Jugosllavinë borgjeze që përfshinte edhe të drejtën e shkollimit në gjuhën amtare. Angazhimi i Komitetit "MKK" në këtë rrafsh vihet re që në fillimet e veprimtarisë së tij, në vitet 1918-1920, që ishte periudha me e suksesshme e veprimtarisë së tij.

Komiteti shtroi dhe kërkoi realizimin e të drejtave elementare politike e demokratike të shqiptarëve në suaza të kuadrit ligjor vendor e ndërkombëtar, siç ishin: e drejta për shkolla fillore në gjuhën amtare, e drejta për themelimin e shkollave private, për themelimin e institucioneve kulturore, për shtypin e lirë, e drejta për përdorimin e lirë të gjuhës amtare etj.²⁷

24 Po aty, f.145. Murat Muhaxhiri , për të mos ra në duar të xhandarmërisë serbe, braktisi Gjakovën dhe u vendos në Krujë në detyrën e mësuesit me shumë kosovar të tjerë që nga ë dhuna serbe lëshuan Kosovën.

25 Pal Doçi vep. cit., f. 146.

26 Po aty, f. 35.

27 Po-aty, f. 35.

Komiteti çështjen e shkollimit e konsideronte si çështje primare dhe të ndarë prej çështjeve fetare.

Hoxhë Kadri Prishtina, udhëheqës i Komitetit KMK e vlerësonte lartë fushën e ligjeve arsimore dhe të programeve shkollore. Ai theksonte se duhet pasur kujdes që ligjet e programet të jenë sa më praktike. Në ligjet e hartuara nga ai çështjet e arsimit zënë vendin e merituar. Bile, komisionin e arsimit ai e vë ndër të parët, madje edhe para komisionit të drejtësisë. Është e nevojshme të shtohet edhe kontributi i tij në emancipimin e femrës shqiptare. Arsimin, edukatën dhe kulturën, ai nuk e quan dhunti për meshkujt, por shprehet se për ta çuar shoqërinë shqiptare përpara duhet luftuar për ta çliruar gruan, në mënyrë që edhe ajo të zërë vendin e merituar në shoqëri. Kjo sipas tij, arrihet me arsimimin e saj ku vet gratë shqiptare duhet ta drejtonin arsimimin dhe edukimin e vajzave.²⁸ Hoxha Kadriu mendonte se burri e gruaja duhet të kenë barazi interesash shoqërore, ekonomike, mendimi dhe moshe. Ky mendim për kohën ishte mjaft i avancuar.

Komiteti pas vitit 1920 kishte paraparë orientime të reja programore. Në kuadër të këtyre ndryshimeve Hasan Prishtina shprehej: Kurrfarë taktike me Qeverinë serbe rreth çështjes së shkollimit sepse Kosova përkrah përbërja kombëtare dhe faktet historike është pjesë e Shqipërisë prandaj edhe shkollimi dhe administrata duhet të mbahen shqip.

Komiteti "MKK" u drejtoi një varg peticionesh për të drejtat kombëtare të Kosovës Konferencës së Paqes dhe qeverive të shteteve pjesëmarrëse në të, kontribuoi në bashkimin politik të popullit për mbrojtjen kombëtare, duke u bërë kështu drejtuesi dhe autoriteti më i lartë i politikës kombëtare.²⁹ Fillimisht, përpilues i pjesës më të madhe të letrave e të peticioneve ishte kryetari i Komitetit "MKK" Hoxhë Kadri Prishtina, ndërsa në fazat në vijim të veprimtarisë së këtij komiteti që përfshinë përrudhën 1925-1933, këtë rol e mori Hasan Prishtina. Ai ishte hartues i një varg peticionesh e memorandumesh që iu drejtuan Lidhjes së Kombeve brenda viteve 1924-1931, me anë të të cilave kërkohej realizimi i të drejtave të popullit shqiptarë në Jugosllavi.³⁰

28 Pal Doçi, *Hoxha Kadri*, vep. cit., f. 148.

29 *Komiteti "MKK"* (përmbledhje punimesh) Tiranë 2004, f.15.

30 Po aty, f. 35.

Në këtë frymë u shkrua edhe peticioni i tre priftërinjve autoritar katolik (Gjon Bisaku, Shtjefën Kurti, Luigj Gashi) dërguar Lidhjes së Kombeve në Gjenevë me 5 maj të vitit 1930 i paraqitur me të dhëna të hollësishme për gjendjen e vështir të arsimit në viset shqiptare në Jugosllavi. Qeveria jugosllave e arsyetonte këtë gjendje me mungesën e kuadrit arsimor shqiptar duke u shprehur, se vështirë mund të gjendet ndonjë mësues që mund të ligjëronte shqip dhe se ata nuk dëshirojnë të arsimohen.³¹ Këtë politikë të Mbretërisë Jugosllave e demantojnë me 1930 kur në Lidhjen e Kombeve paraqiten tre priftit katolik shqiptar nga Kosova sipas të cilëve në Kosovë kishte 27 mësues shqiptar që kishin qenë të detyruar ti mbyllin shkollat e tyre nga pushteti.³²

Mirëpo, Lidhja e Kombeve, përkatësisht organet e saj, zvarritnin marrjen e qëndrimeve ndaj peticioneve e memorandumëve të shqiptarëve me prirjen për t'ia lënë kohës, siç ndodhi edhe me memorandumin e tre priftërinjve shqiptar. Kjo neglizhencë e Lidhjes së kombeve e favorizonte Mbretërinë Jugosllave në veprimet antishqiptare dhe acaroi në mas gjithë botën shqiptare e veçmas veprimtarët e KMKK.

Komiteti i Kosovës në vitet 1941-1943, në kohën kur shkolla shqipe dhe arsimit shqip hyri në një kthesë pozitive të zhvillimit të saj, angazhohet në hapjen e shkollave shqipe në trevat shqiptare.³³

Bartësit e këtij Komiteti me në krye Bedri Pejani u kthyen nga Shqipëria për t'u angazhuar në organizimin e administratës civile dhe hapjen e shkollave në gjuhën shqipe në Kosovë dhe trevat tjera shqiptare.³⁴

Në suitën e Bedri Pejanit, që kishte marrë detyrë për të organizuar arsimin në Kosovë ishin: Jonuz Blakqorri, Osman Tetova, Avdush Kastrati, Tefik Begolli, Hasan Rexha, Hamdi Gashi, Xhemajl Beg prishtina, Bedri Gjinaj, Banush Sedllari, Xhevdet Doda, Ismail Gjini, Emrush Kabashi, Ragip Karabegolli, Riza Ferri, Haki Taha, Zeqir Rexha, Hysen Murati, etj.³⁵

31 Muhamet Pirraku, *Kulturni profetni pokret albanaca u Jugoslavij i (1919-1941)*. JIÇ, 1978 nr-4. f. 356-370.

32 Po aty.

33 Hakif Bajrami, *Ibrahim Gjakova shtyllë e Komitetit të Kosovës*. Prishtinë 2000. f. 68.

34 Sulltane Ukaj, *Roli i Zhuk Haxhis në qëndresën kombëtare*. "Kosova" Nr. 28. Prishtinë 2006, f. 257.

35 Hakif Bajrami, vep. cit., f. 68.

Ky grup kontribuoi në hapjen e shkollave shqipe në Kosovë, Maqedoni e Mal të zi.

Në mesin e të kthyerve kishte edhe nga ata që kishin përfunduar ndonjë nga shkollat në Shqipëri. Kjo plejadë shkollarësh në rrethana të ndryshme historike u bënë bartës të proceseve arsimore e politike në Kosovë.

Nuk mund të anashkalohet fakti se Kosova gjatë viteve 1941-1944 iu bashkua Shqipërisë, dhe për katër vite u krijua një elitë intelektualesh që morën mbi vete barrën e kombit, u formua një administratë dhe një përvojë udhëheqëse, një arsim kombëtar që vunë themelet e arsimit institucional. Dhe krejt në fund, në të gjitha proceset pozitive rol të rëndësishëm pati Komiteti MKK, përkatësisht bartësit e tij.

Prof. dr. Sulltane KOJQINI-UKAJ

SUMMARY

EDUCATIONAL CONTRIBUTION OF THE NATIONAL COMMITTEE FOR DEFENSE OF KOSOVA

After the World War I, in 1918, Kosova was occupied by numerous Serbian forces. Belgrade took stringent measures against Albanians in Kosova, because of their national consciousness and efforts for education in their native language. The primary objective of this policy was to leave Albanians in the darkness of ignorance, so they would not be in position to fight for their national rights.

Education in Serbian schools was deemed by the Kingdom of Serbia, Croatia and Slovenia as appropriate form in order to organize the institutional denationalization and assimilation of Albanians, who had remained part of the Kingdom during 1918-1941.

This policy led Albanian youth to find alternative ways for education in mother tongue. Only, choice to achieve this has been the education in Albania by illegal border crossing. For these youngsters catered Albanian state and the Committee of NDK, established in Shkodra, on May 1, 1918.

Albanian Committee singled out the education as a key pillar for the national emancipation. The Committee raised and urged the implementation of basic democratic rights' of Albanians to education in mother tongue. For this it directed a series of petitions to the Peace Conference of Paris and the participating states. In this spirit, the petition was written by three authoritative Catholic priests (Gjon Bisaku, Shtjefen Kurti, Luigj Gashi) sent to the League of Nations in Geneva in 1930, which presented detailed account on the plight of education in the Albanian territories in Yugoslavia. The Committee of Kosova during the period between 1941 and 1943 was involved in establishing Albanian schools in Kosova, Macedonia and Montenegro.